

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dea Mishel shpërthen ndaj deputetes së PS-së: Mos e përdor feminizmin për t'u viktimizuar
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/09/dea-mishel-shperthen-ndaj-deputetes-se-ps-se-iris-luarasi-o-krve/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 16:24:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 16:20:01 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1f7dbf3b286e06bb3a530c71089b7b4c0704cc305cf8d76982c7474b38fc0827
TEKSTI	12e38951e0099b9c411df55362992b1fb70f0f8eb18a98b1435d17614c298bd4
PAMJA	283155fca5cf6a2a71d5e31adc62ad9dcb45f75bb728d3848e64fe2d10c7c3d8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2db692976be0553144de7b422c81a8e1960791d30e2d188ad325dfb89df465f3
E MËPARSHMJA	76cb5af4a8ec307984dd318ca38bb35c5a43b9ca54544bdef667f477c0a90da5
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2db692976be0553144de7b422c81a8e1960791d30e2d188ad325dfb89df465f3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Kontakt](#)

 [BoldNews.al](#)

Wednesday, September 9, 2026



Kërko..

Nuk ka rezultat

[View All Result](#)

- [KRYESORE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [OP-ED](#)
- [VETTING](#)
- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKE](#)
- [SPORT](#)
 - [Botëroni 2026](#)
- [TE TJERA](#)
 - [PRIVACY POLICY](#)
 - [KONTAKT](#)
 - [EKONOMI](#)
 - [SHENDETI](#)
 - [SHOW BIZ](#)
 - [KULTURE](#)
 - [POLITIKE](#)
 - [KRONIKE](#)
 - [TEKNOLOGJI](#)
 - [VIDEOT KRYESORE TE DITES](#)
 - [VIDEO](#)
 - [BOLD BLOG](#)
 - [FOTOGRAFI](#)
 - [HOROSKOPI](#)
 - [NDRYSHE](#)
 - [RAJONI](#)
 - [BOTA](#)
 - [SOCIALE](#)
- [ZGJEDHJE 2025](#)

- [KRYESORE](#)

 [BoldNews.al](#)

[Fillimi](#) [AKTUALITET](#)

Dëa Mishel shpërthen ndaj deputetes së PS-së: Mos e përdor feminizmin për t'u viktimizuar

18:20 : 09/09/2026

në [AKTUALITET](#), [Lajmet e Dites](#), [SHOW BIZ](#)



- [Botëroni 2026](#)

- [PRIVACY POLICY](#)

- [KONTAKT](#)

- [EKONOMI](#)

- [SHENDETI](#)

- [SHOW BIZ](#)

- [KULTURE](#)

- [POLITIKE](#)

- [KRONIKE](#)

- [TEKNOLOGJI](#)

- [VIDEOT KRYESORE TE DITES](#)

- [VIDEO](#)

- [BOLD BLOG](#)

- [FOTOGRAFI](#)

- [HOROSKOPI](#)

- [NDRYSHE](#)

- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [SOCIALE](#)

•

Influencerja Dea Mishel Hoxha ka reaguar pas shoqërimit nga policia të aktivistes Arvina Lleshi, e cila u përfshi në një përplasje me deputeten socialiste Iris Luarasi gjatë protestës së zhvilluar mbrëmjen e djeshme.

Luarasi ishte përballur me disa protestuese teksa po shkonte drejt Kuvendit për të marrë pjesë në seancën plenare. Gjatë përplasjes verbale, vajzat e kanë akuzuar deputeten duke i thënë ndër të tjera “hajdute” dhe duke i kërkuar të mos flasë në emër të grave.

Pas ngjarjes dhe shoqërimit të Arvina Lleshit, Dea Mishel ka publikuar një reagim të gjatë, duke kundërshtuar deklaratat e Luarasit dhe duke argumentuar se kritikët politike nuk duhen interpretuar si dhunë me bazë gjinore.

Sipas saj, fakti që dy protestuese e kanë akuzuar Luarasin si “vegël të qeverisë” dhe “hajdute” nuk përbën antifeminizëm, por është pjesë e revoltës së tyre politike.

Dea Mishel i kërkon deputetes, të cilën e cilëson si akademike dhe feministe, të bëjë dallimin mes sulmit për shkak të gjinisë dhe kritikës ndaj një përfaqësueseje politike.

Lexo edhe:

[Aktivistja: Më 7 shtator, protesta e 100-të, të gjithë në shesh! Nuk ndalemi pa ikur kjo klasë politike](#)

["Nuk na trembni me arrestime", aktivistja: Prangat duhet t'ua vendosni atyre që janë në qeveri](#)

Ajo ngre gjithashtu pikëpyetje mbi qëndrimin e Luarasit për çështjen e Onkologjikut, duke pretenduar se deputetja nuk ka dhënë përgjigje të kënaqshme lidhur me situatën e pacientëve me kancer dhe mungesën e barnave. Këto janë pretendime të bëra nga influencerja në reagimin e saj.

Pjesën më të fortë të deklaratës, Dea Mishel e lidh me shoqërimin e Arvina Lleshit. Ajo pretendon se aktivistja është marrë nga policia gjatë natës, ndërsa po udhëtonte me taksì, dhe se në trupin e saj ka shenja të shkaktuara gjatë ndërhyrjes policore.

“Arvina duhej të merrte një lajmërim dhe jo të arrestohej në mes të natës”, shprehet ajo, duke ngritur pyetjen se ku mund të drejtohet një qytetar në rast se pretendon se është dhunuar nga policia.

Në fund, Dea Mishel i drejtohet drejtpërdrejt Luarasit, duke e pyetur se çfarë mesazhi përcillet për gratë dhe vajzat që protestojnë nëse ngritja e zërit ndaj qeverisë përfundon me shoqërim policor.

Reagimi i Dea Mishel Hoxha: Iris Luarasi, o kurvë. Ky është një shembull i dhunës me bazë gjinore ose, ndryshe, antifeminizmit, të sulmosh një grua, në moral, në parim. Nëse do të ishte cenuar në këtë mënyrë, si feministe, do të të mbroja dhe unë. Sulmi verbal që ka ndodhur ndaj teje është tërësisht tjetër. Dy vajza që të quajtnë vegël të qeverisë së korruptuar dhe hajdute, dhe nuk janë antifeministe. Ato janë dy protestuese të pakënaqura nga qeveria, ku ti bën pjesë.

Do të shpresoja që një akademike si puna jote do ta dinte ndryshimin midis këtyre dy termave bazikë dhe nuk do ta përdorte feminizmin për t'u viktimizuar. Është shumë e turpshme ta bëjë një njeri që pretendon se është feministe. Të përdorin kauzën dhe ta shtrembërojnë sipas nevojës së vet.

Në qoftë se do të ishte kaq feministe, Iris, do të kishe dhënë një përgjigje pak më të saktë kur të pyetën për skandalin e Onkologjikut, ku nuk ka ilaçe. Në Onkologjik ka gra që dihet që vuajnë nga kanceri, por ti jep një përgjigje për të dalë nga situata skandaloze aq e tmerrshme, sa dhe vetë e di dhe e ke fshirë nga çdo rrjet social.


Nëse do të ishte feministe, nuk do të kishe urdhëruar që Arvina të arrestohej në mënyrë çnjerëzore. Duhet të kishte marrë një lajmërim dhe jo të arrestohej në mes të natës nga policia, që duken si hajdutë, duke e marrë nga taksia me të cilën do të shkonte në shtëpi.

Nëse do të ishte feministe, do e kishe respektuar revoltën e qytetarit të shtetit tënd dhe nuk do ta poshtëroje atë, nuk do ta arrestoje atë në mes të natës si kriminele. Iris, ti thjesht po i mëshon faktit që je kriminele, ti po i jep të drejtë asaj vajze.

Çfarë thotë kjo për sigurinë e vajzave në vendin tënd? Që, nëse ne ngremë zërin dhe flasim, mund të dalim në rrugë dhe të arrestohemi në mënyrë të dhunshme nga policia e shtetit, pa asnjë lajmërim? Vajza ka shenja në trup që ia ka bërë policia e shtetit. Ku mund të ankohet ajo për këtë gjë? Ma thuaj ti, si feministe! Nëse policia të ka ushtruar dhunë në mënyrë të padrejtë, atëherë ku mund të drejtohesh ti për t'u mbrojtur? Ma thuaj ti, Iris, si feministe!

Etiketa: [aktivistjadea mishel. iris luarasiofendime](#)

Lajme të lidhura





[Aktivistja: Më 7 shtator, protesta e 100-të, të gjithë në shesh! Nuk ndalemi pa ikur kjo klasë politike](#)

[20:32 : 03/09/2026](#)



["Nuk na trembni me arrestime", aktivistja: Prangat duhet t'ua vendosni atyre që janë në qeveri](#)

[20:22 : 02/09/2026](#)




[Incidentet në protestë, aktivistja: Askush s'mund të na përçajë! Rama në burg, Berisha në burg](#)

[20:26 : 17/08/2026](#)



[Nga ofendimet te non gratat, si e ka ndryshuar Rama narrativën e protestës](#)

14:12 : 10/07/2026



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.